REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC
SEKTORI I FINANCËS

Nr.253 /1 Prot

Pustec, më 19.02.2026

PROJEKT - VENDIM
Nr.3 Datë 19.02.2026

PËR PJESËN E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2025 PËR VITIN 2026

Në bazuar në ligjin nr. 139 date 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1. 1 gërma "b, neni 55 "votimi "pika 3, neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma (dh), si dhe Ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 ''Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.Shqiperise''i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.664 datë 24.10.2025, Për propozimin e projektligjit "Për buxhetin e vitit 2026". shkresës së Ministrisë së Financave nr.15867 prot, datë 06.11.2025 " Mbi detajimin e fondeve për transfertën e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transfertën e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2026, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.629 datë 03.11.2025 "Për miratimin e projektligjit "Për buxhetin e vitit 2026" , Ligji nr.68 date 27.04.2017 ''Per financat e vetqeverisjes vendore" i ndryshuar. Dergohet per njoftim transferta e pakushtezuar e pergjithshme dhe sektoriale për vitin 2025,,

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, kërkohet nga Këshilli Bashkiak:

TË MIRATOJ

1. Miratohet përdorimi i të ardhurave të trashëguara nga viti 2025 në buxhetin e vitit 2026 në shumën totale 77,130,461.03 lekë, sipas klasifikimit funksional dhe ekonomik të buxhetit.
2. Fondi i miratuar do të përdoret për:

   e) Mbuluar shpenzimet për paga, shpërblime dhe kontribute të sigurimeve shoqërore.
   f) Përballimin e shpenzimeve operative për funksionimin normal të administratës dhe shërbimeve publike.
   g) Realizimin e investimeve kapitale, përfshirë studime e projekte, përmirësim infrastrukture, blerje pajisjesh dhe mjetesh, si dhe investime të tjera prioritare.
   h) Krijimin dhe përdorimin e fondit rezervë dhe fondit emergjent, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Shpërndarja e fondeve do të realizohet sipas programeve buxhetore për Administratën e Përgjithshme, Arsimin, Shërbimet Bujqësore, Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike, Pyjet dhe Kullotat, Menaxhimin e Mbetjeve, si dhe Mbrojtjen nga Zjarri dhe Emergjencat Civile, sipas tabelave financiare bashkëlidhur këtij vendimi, të cilat janë pjesë përbërëse e tij.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Financës për zbatimin e këtij vendimi, respektimin e procedurave ligjore në fuqi për realizimin e shpenzimeve dhe investimeve,

si dhe raportimin periodik pranë Këshillit Bashkiak mbi ecurinë e përdorimit të fondeve të miratuara.

5. Çdo ndryshim në destinacionin e fondeve do të kryhet vetëm me miratim të Këshillit Bashkiak, në përputhje me legjislacionin përkatës.
6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Financës për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

PËRGJEGJEËS I SEKTORIT TË FINANCËS
CVETKO NASTO

KRYETARI I BASHKISË
PALI KOLEFSKI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PUSTEC